

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit Q.A. nga fsh..... komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr.700-4/16 të dates 25.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me dt. 10.06.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Ismet Rrahmani, si dhe të akuzuarit Q.A. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av.Jakup Ramadani, të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **Q.A.**, nga fsh..... komuna Ferizaj, data e lindjes., nga i ati T. dhe e ëma A. e gjinisë B., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, prind i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse më date 14.06.2016, rreth ores 16.00, në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Ferizaj, gjer sa i dëmtuari A.S. shtetas i Austrisë ishte duke u shëtitur, i pandehuri i është ofruar të dëmtuarit për të bërë fotografi së bashku, në atë moment kur i dëmtuari e ka hap çantën i pandehuri ka vërejtur se i dëmtuari kishte portofolin me të holla, nga çanta ia merr atë dhe ka ikur nga aty, në portofol i dëmtuari kishte shumën rreth 600€ si dhe kartela të ndryshme të bankës, më pas është zbuluar dhe arrestuar nga ana e policisë,

me të cilën kreu veprën vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,41,43,45, 46 dhe 73 të KPK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

DENIM ME GJOBË në lartësi prej 200 (dyqind) euro, të cilin denim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili denim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në të cilin denim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dates 14.05.2016 e deri më 10.06.2016.

Nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burg.

I dëmtuari A.S. – shtetas i Austrisë me nr.telefoni 043-....., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.700-4/16 të dt.25.05.2016 e ka ngarkuar të pandehurin Q.A. për veprën penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 10.06.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri Q.A., në shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke theksuar se për këtë veprë është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt.15.05.2016, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të dt.15.05.2016, deklarata e të dëmtuarit e dt.16.05.2016, deklarata e të pandehurit e dt.15.05.2016 si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, se është i martuar dhe prind i një fëmijëve, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, e në mungesë të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, të pandehurit i vërtetoi dënim me gjobë në shumën prej 200 (dyqind) Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 /katër/ muaj i cili dënim po ashtu do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me bindjen se në rastin konkret edhe përmesë shpalljes së dënimit dhe pa ekzekutimin e tij do të arrihet qëllimi i dënimit me kusht dhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejt në raport me peshën e veprës penale, rrethanave të kryerjesë së vepres penale, shkallen e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurit.

I dëmtuari A.S. – shtetas i Austrisë me nr.telefoni 043-....., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së me aktvendimin P.nr.450/16 të dt.10.06.2016 me dt.10.06.2016 të akuzuarit i është ndërprerë masa e paraburgimit.

Konform nenit 83 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar me burgim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.14.05.2016 deri me dt.10.06.2016.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.450/16, dt.10.06.2016**

Sekretarja Juridike ,
Drita Ujupi

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.

